



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 47 Prot

Tiranë, më 24/05 2013

VENDIM Nr. 15 dt. 10.05.2013

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, “Për Trashëgiminë Kulturore”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 10.05.2013, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës, lidhur me pikën 2 të rendit të ditës për Kalanë e Lezhës:

VENDOSI:

1. Afati i qerasë për projektin “Rijetëzimi i Kalasë Mesjetare të Lezhës”, të jetë 20 vjet.
2. Vlera e investimit në dobi të monumentit, që do të kryhet nga investitori “Schnell” shpk, do të çertifikohet nga IMK.
3. Pagesa e qerasë do t’i shlyhet nga kjo vlerë investimi, sipas rregullave që do të përcaktohen në kontratën përkatëse të qeradhënies.
4. Kryerja e punimeve të gërmimit arkeologjik dhe punimeve të restaurimit në objekt do të bëhen përkatësisht nga Agjensia e Shërbimit Arkeologjik dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

VISAR ZHITI

SEKRETAR I KKR
AKADEMIK, APOLLON BAÇE

Rruga “Aleksandër Mojsiu”, nr. 76, Tiranë (AL), Email: imk@albmail.com